REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 93/17
Datë/Datum 24.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komuna Prishtinë".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr. 93/17.**
Nga:	Zenel Hisenaj – Ekspert Teknik Visar Bibaj – Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk" Ritender,** me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"PBC",shpk, - Prishtinë**		
Datë	**24.04.2017**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk" Ritender** me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"KK Prizren",** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"PBC" shpk me seli në Prishtine** me nr. prot. **93/17,** të datës 31.03.2017.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		12.04.2017		20.04.2017		24.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **31.03.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **93/17**, e parashtruar nga OE "**PBC**"- **shpk** me seli në Prishtine, lidhur me aktivitetin të prokurimit "**Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile - E Kiosk**" - **Ritender** me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prishtinë.**

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues - teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Prishtinë.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "PBC" me seli në Prishtine.

Pikat e Ankesës nga OE **"PBC"** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:

- **Paragrafin e 25.7 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publike**
- **Paragrafin e 20.4 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publike**
- **Vendimin e OSHP-s nr. 360/16**
- **Paragrafin e 6 te nenit 53 te Ligjit për Prokurim Publik**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur paragrafin 25.7 te rregullores dhe udhëzuesit Operativ për prokurim publik, sepse:
   a. Ka ndryshuar kushtet dhe kërkesat (Kapaciteti teknik dhe profesional) i dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, nga OE duhet te jete i autorizuar për shitje dhe instalim te pajisjeve qe ofron ne " Kërkohet CE certifikimi" e te njëjtat nuk i kan publikuar sikurse e definon kjo dispozite ligjore. Edhe pse pyetje jone ishte për krejt tjetër gjë e përgjigja e Autoritetit kontraktues, për krejt tjetër gjë.
   Prove: Njoftimi për kontrate, dosja e tenderit, dhe pika e pare e përgjigjeve te datës 21.03.2017
2. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur paragrafin 24.4 te Rregullave dhe te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. TER nuk janë te qarta, e sakta dhe precize, ne kuptimin qe nuk saktësohet/precizohet se a do te vendosen kabinat, te cilat kushtojnë rreth 7,000 Euro copa, ne total te projektit rreth 21,000 Euro edhe për eKioskat qe do te vendosen brenda objekteve te komunës apo jo. Dhe, nëse ato do te instalohen brenda objekteve te komunës a i zënë brenda objekteve te komunës dhe/ose a do te ketë pune shtese për OE ne demolomini e mureve dhe përshtatjen e ambientit për

instalimin e kabinave, te cilat dhe ashtu janë te destinuara për ambiente te jashtme e jo për brenda objekteve te komunës. Për me tepër, shihni një skice te përafërt te kabinave te tilla, ne aneks A te kësaj ankese.

Prove: Pika nr.3 e përgjigjeve ku thotë se tri do te vendosen ne godina te komunës dhe një jashtë godinës se komunës, nga katër (4) sosh sa dëshirojnë ti prokurojnë.

3. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur vendimin e OSHP-PSH, Nr. 360/16, sepse:
   a. Ne vendimin PSH nr. 360, ne konstatimin e fundit thuhet: [... Megjithatë paneli shqyrtues obligohet AK- Komuna Prishtinë qe te aplikoj paragrafin 7, te nenit 53, te LPP-se ne fuqi, te beje zgjatjen e afatit për ofertomë, dhe te korrigjoj dosjen e tenderit, konkretisht te ndryshoi specifikacionet teknike te detyrueshëm sipas rekomandimeve dhe sqarimeve te raportit te ekspertizës se datës 31.10.2016, me nr. 360/16.] Ndërsa, ne ekspertizën ne fjale, thuhet:

   Po ashtu pretendimi ankimore që lidhet me "Shënimin me rendesi"- të theksuar nga AK, për specłfikacione teknike të detyrueshme, e kualifikojmë si të bazuar, pasi që Autoritet Kontraktues, kundrejt kërkesës për sqarime shtesë është Përgjigjur, si në vazhdim" AK e mban të drejtën që te kërkoj nga OE dhe prezantimin LIVE të funksionalitetit te aparatit nëse kërkohet nga AK, Prandaj nuk është obligative, përveç kërkohet nga AK. Referuar kërkesë se dosjes së tenderit, Specifikimet Teknike, me saktë (OE obligohet qe para vlerësimit te ofertave të prezantojnë pajisjen dhe funksionimin e tij në lokalet e komunës së Prishtinës)".

   - Kërkesa e AK-se, si dhe sqarimi i dhënë kundrejt kërkesës së parashtruesit të ankesës, e tillë vlerësojmë se është e pa arsyeshme perfektin se, këto pajis e janë shumë specifike dhe përgatitja e tyre finale para zgjedhjes se fituesit nuk garanton blerjen e tyre, kur dihet se.

   1. Këto pajisje do te përdoren vetëm për këtë qellim,
   2. Duhet te zhvillohet sistem Për funksionimin e tij.
   3. Duhet te krijohet ndërlidhje me institucionin përkatës.

   Përgatitja e një produkti të tillë dhe prezantimi i tyre në këtë faze do të mund ti shkakton dëme materiale Operatoreve Ekonomike, pasi ky proces nuk garanton shpërblim kontrate. Ndërsa Autoriteti Kontraktues në përgjigjet e datës 21.03.2017, në pikën gjashtë (6) sërish ka kërkuar, saktësisht të njëjtën gjë.

   6. Përgjigja është dërguar ne shkresën e datës 4 tetor 2016. AK e mban të drejtën qe të kërkoje nga OE edhe prezentitmin LIVE të funksionalitetit dhe të dizajnit të aparatit nëse kërkohet nga AK. Qëllimi është që të dëshmohen kërkesat e parashtruara në specifikim.

   Provë: Vendimi i OSHP nr. 360/16, Ekspertiza nr. 360/16 dhe përgjigja e AK'së, pika 6

4. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 6 të nenit 53 të Ligjit nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit Udhëzuesit Operativ Për Prokurim Publik, SEPSE:
   a. Nuk na ka dhënë informacione të plota - kundrejt kërkesave tona Për pikën 12, 13 dhe 17, por vetëm ka thënë përmbajuni kërkesave të Dosjes Së Tenderit, edhe pse si rezultat i kërkesave të Dosjes Së Tenderit ishte paraqitur nevoja e patjetërsueshme Për sqarime shtesë, pasi që ato çështje lidhen drejtpërsëdrejti me koston financiare të ofertës dhe një devijim sado i vogël mund ta rangoj ofertën tonë me çmim më të lartë sesa ofertat e konkurrentëve tjerë.

Provë: Kërkesa jonë Për informata shtesë dhe përgjigjet e AK'së Së dt. 21.03.2017.

Prandaj, bazuar në këto që u thanë më sipër, fuqishëm konstatojmë se Autoriteti ka vepruar në kundërshti me dispozitat ligjore, të theksuara më sipër dhe që ky proces i prokurimit të RITENDEROHET dhe të riniset një procedurë garanton barazi dhe integritet ndërmjet operatorëve ekonomik.

Për vëmendjen tuaj, kjo është ankesa e 3 (tretë) që dorëzohet Për këtë procedurë në OSHP dhe veç tek AK kemi dorëzuar 5-6 kërkesa Për Rishqyrtim, por ato asnjëherë nuk merren parasysh dhe AK iu bishtnon obligimeve ligjore.

Demi Material

Pamundësia e pjesëmarrjes ne këtë procedure prokurimi, përkatësisht implementimit potencial te kësaj kontrate, kompanisë sonë i pamundësohet profiti monetar ne vlere prej hiç me pak se 4,500 EUR.

Propozimi *Te kthehet lënda ne* Ri Tenderim

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 13.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: ..... Furnizim/vlerë e mesme

Data e hapjes se ofertave pas vazhdimit te afatit..... 03.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
   Dëshmitë tjera lidhur me kërkesat e pranueshme risë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet
   Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshme risë janë me se vijon:
2. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit- **Vërtimin nga Gjykata** Ekonomike-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës
3. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] - Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi (duhet dorëzuar së

bashku me tenderin).

2. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës- për te propozuarin për kontrate.
3. Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënieje të kontratës- për te propozuarin për kontrate.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat:

1. Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve
2. Certifikatë e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e certifikatës se regjistrimit të biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara
2. Kopja e certifikatës se numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A

Kërkesa

1. Qarkullimi për furnizime të ngjashme në tre vitet e fundit-2013,2014,2015 - minimum 75,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Raportin-tet bankare apo konfirmimin nga një apo me shume banka për qarkullimin e kërkuar

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional.

Kërkesa:

1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar furnizime – shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015).
2. OE duhet të jetë i autorizuar për shitje dhe instalim të pajisjeve që oferton.
3. OE duhet të ofroj certifikatë ose deklarate te cilësisë se produkteve qe oferton
4. Stafi –
   a. Një inxhinier te shkencave kompjuterike
   b. Një inxhinier te elektronikës apo te telekomunikacionit
5. OE duhet të ofroj Broshurat për produktet e ofruara

Dëshmia e dokumentuar:

1. Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015) për furnizime - shërbime te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve në 3 vitet (se paku dy referenca apo certifikata te pranimeve) duke saktësuar:
   a. punët e përfshira,
   b. shumën e kontratës,
   c. datën dhe pranuesin.
2. Autorizim nga prodhuesi për shitjen dhe servisimin e tyre.
3. Kopje te certifikatës te cilësisë se produkteve
4. Stafi te dëshmohet me kopje te diplomave dhe me kontrata për marrëdhënie pune
5. Broshurat apo katalogët për produktet e ofruara

Analiza dhe sqarimet e ekspertit teknik

Ekspertet e OSHP-së, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqarojn me sa vijon:

Saqrim hyrës Pretendimet ankimore janë shqyrtuar – trajtuar nga eksperti teknik, pasi që i njejti të gjitha shkresat e lëndes i ka patur në posedim deri në datën e dorëzimit të këtijë raporti.

Sqarimi nr. 1 Autoriteti Kontraktues - **"Komuna e Prishtinës "**, gjatë këtijë aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: **"PBC"shpk,** ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit, kundër njoftimit për kontratë.

Kundër njoftimit për kontratë, parashtruesi i ankesës më datën. 19.03.2017, paraqet kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet ankimore se AK, ka bërë shkelje të nenit 53 paragrafi 4, 7, 9, nenit 108/A si dhe Vendimin e PSH-së nr 12/17. AK- Komuna Prishtinë, më datën. 21.03.2017, nxjerr vendim dhe aprovon kërkesën si të bazuar pjesërisht, dhe bënë zgjatjen e afatit për dorëzim të ofertave.

Sqarim nr 2. Pretendimin ankimor që lidhet me termet e referencës, ku parashtruesi i ankesës potencon se të njejtat terme nuk janë të qarta, sakta dhe precize, gjegjësisht me lokacionin e vendosjes së kabinave, e kualifikojmë si të pa bazuar, pasi që AK – Komuna Prishtinë, ka sqaruar për ofertuesit se tri (3) e-kioska, do të vendosen në Godinen – Objektin e Komunës, ndërsa një (1), jashtë Godinës – Objektit të komunës, dhe atë përmes përgjigjës elektronike të datës 21.03.2017, konkretisht përgjigjja nen b), e pyetjes nr. 6.

Pretendimet tjeta ankimore poashtu kanë të bëjenë termet e references gjegjesisht me kërkesën e përcaktuar tek specifikacionet teknike të detyrueshme: *"AK e mban të drejtën që te kërkoj nga OE dhe prezantimin LIVE të funksionalitetit te aparatit nëse kërkohet nga AK"*, si dhe *"Perdorimi i skanerit të shenjave të gishtit"*. Të njejtin pretendim ankimore e kemi trajtuar edhe përmes raportit paraprak për këtë aktivitet të prokurimit, poashtu edhe Paneli Shqyrtues përmes vendimit me nr. 360/16, ka obliguar AK- Komuna Prishtinë që të aplikoj paragrafin 7, të nenit 53, të LPP-së në fuqi, të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim, dhe të korrigjoj dosjen e tenderit, konkretisht të ndryshoj specifikacionet teknike të detyrueshëm sipas rekomandimeve dhe sqarimeve të dhëna në raportin e ekspertizës të datës 31.10.2016, me nr. 360/16. Kundrët të njejtit vendim AK – Komuna Prishtinë, ka bërë zgjatjen e afatit mirëpo nuk ka ndryshuar specifikacionet e tilla sipas rekomandimeve të dala me raportin paraprak të ekspertizës, rrjedhimishte të njejtat pretendime i kualifikojme si të bazuara.

Mendimi i ekspertit teknik:

Eksperti teknik bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues qe aktiviteti i prokurimit: **"Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk",**, me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121**, të ANULOHET, dhe nese AK, ka ende interes per te ta ritenderoj, ndersa ankesa e OE "PBC" shpk, të aprovohet si e bazuar pjeserisht.